



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

ARTIKUJT

GRADAT E MËDHA TË SHËRBIMIT TË POLICISË SË SHTETIT

GRADAT E VOGLA TË GJOKSIT, NUMRI I IDENTIFIKIMIT DHE SHENJA E MBIEMRIT

GRADAT E MËDHA CEREMONIALE TË POLICISË SË SHTETIT

STEMA E POLICISË DHE SHENJAT DALLUESE TË KRAHUT PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KORDONAT DEKORATIVË PËR UNIFORMËN CEREMONIALE TË POLICISË SË SHTETIT

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.55 dt.27.01.2016 të ndryshuar me V.K.M-në Nr.399 dt 01.06.2016 dhe me ndreqje gabimi e botuar në fletoren zyrtare Nr.123, Viti 2016 i ndryshuar me VKM nr. 512, datë 04.09.2018. Këto *Specifikime Teknike* parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.

Specifikimet Teknike përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesoreve që duhet të shoqërojnë artikullin.

Prodhuesit janë të detyruar që t'i zbatojnë të gjitha specifikimet teknike të këtij dokumenti.

Sipas nenit 51 të ligjit 108/2014 datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit" dhe VKM nr. 512 datë 04.09.2018 gradat e Policisë së Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen si më poshtë:

1. INSPEKTOR
2. INSPEKTOR I DYTË
3. INSPEKTOR I PARË
4. NENKOMISAR
5. KOMISAR
6. KRYEKOMISAR
7. DREJTUES
8. DREJTUES I PARË
9. DREJTUES I LARTË
10. DREJTUES MADHOR

› Shenjë shërbimi për kursantë/studentë.

Gradat e mëdha të Shërbimit të Policisë së Shtetit sipas rangut

HYRJE

Gradat e mëdha të Shërbimit të Policisë së Shtetit për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të vendosen lart në të dyja supet të çdo artikulli të uniformës që kanë spaleta për vendosjen e tyre.

Gradat dhe elementët saj dekorativ duhet të prodhohen me materialet dhe format e kërkuara nga Policia e Shtetit. Ato duhet të prodhohen në bazë të pamjes së jashtme, modelit, përmasave dhe ngjyrave të përcaktuara në këtë dokument.

		
Inspektor	Inspektor i dytë	Inspektor i parë
		
Nënkomisar	Komisar	Kryekomisar

		
Drejtues	Drejtues i Parë	Drejtues i Lartë
		
Drejtues Madhor	Shenja Student/kursant	

TE DHENAT TEKNIKE PER PRODHIMIN E ARTIKUJVE

"Gradat e mëdha të shërbimit të Policisë së Shtetit"

1. MATERIALET

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit *Gradat e mëdha të Shërbimit të Policisë së Shtetit* ndahen në:

- Materiali i bazamentit
- Elementët dekorativë në PVC (polivinil kloruri) dhe të qëndisur

a. Materiali i bazamentit duhet të jetë tekstil ngjyrë blu i errët, i cilësisë së I-rë, i përforcuar nga brenda me silikon i cili bën bashkimin me një shtresë polivinil kloruri (PVC) që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet. Materiali i përdorur duhet të jetë rezistent ndaj efektit të agjentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës. Materiali i bazamentit duhet të ketë këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja % ($\pm 5\%$)	50% Lesh	50 % Poliester
Thurja	Diagonale e dërstiluar	
Masa gr/m ² ($\pm 5\%$)	220gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 4500 cikle	
pH	4-9	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Elementët dhe materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit "Gradat e mëdha të Shërbimit të Policisë së Shtetit" janë :

Elementë plastikë			
Elementë dekorativë plastikë që vendosen brenda gradës si Korniza, yjet, shiritat	Përbërje	100% Polivinil Kloruri PVC	
	Ngjyra	E artë dhe e kuqe	
Tekstil			
Shirit prej tekstili për gradat e Drejtuesve të Lartë dhe Madhor.	Përbërja	100 % Mëndafsh	
	Ngjyra:	E artë	
Fije metalike			
Fill metalik për qëndisjen e elementëve të gradave të Drejtuesve të Lartë dhe Madhor	Përbërja:	Metalike	
	Ngjyra	E artë	
Shufra metalike			
Shufra të holla prej metali me dy forma të ndryshme	Përbërja:	Metalike	
	Ngjyra:	e artë	
	Forma	tubolare	sustë

Të gjithë këto elementë dhe aksesore, mund të zëvendësohen me material të ngjashëm, vetëm nëse kanë karakteristika të barabarta dhe/ose të përmirësuara, që t'i përgjigjen plotësisht specifikave të kërkuara për prodhimin e produktit.

KUJDES! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit grada të mëdha shërbimi:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietileni që mbyllet me ngjitje për paketimin e një palë grada	1 letër e hollë për paketimin e një palë gradave
1 kuti kartoni për paketimin e 60 cifte gradash	

2. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu për bazën e gradës sipas spektrit CIELCH **18, 14.587, 295.349**.

Ngjyra e kuqe për kornizën anësore sipas spektrit CIELCH **41, 70.780, 28.754**

Ngjyra e artë për elementët plastikë, elementët me qëndisje dhe tekstin prej mëndafshi sipas spektrit CIELCH **72, 63.619, 74.057**.

Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyra që prodhuesi duhet t'i ketë si referencë. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

3. PËRMASAT E GRADAVE

Bazamenti i gradës ka pamje të sipërme trapezoidale dhe duhet të ketë këto përmasa:

- nga rangu *Inspektor* deri tek rangu *Drejtues i Parë*, gjatësia e gradës duhet të jetë 90 mm ndërsa gjerësia e trapezit – 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël;
- për rangjet *Drejtues i Lartë* dhe *Drejtues Madhor*, gjatësia e gradës duhet të jetë 105 mm ndërsa gjerësia e trapezit - 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël.

Kujdes!!! Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

4. SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *Gradat e mëdha të Shërbimit të Policisë së Shtetit* duhet të prodhohen në çifte, sipas sasisë së specifikuar nga porositësi. Prodhuesi ka për detyrë që të parashikojë prodhimin e kësaj sasie saktësisht sipas specifikimeve të porositësit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I BAZAMENTIT TË GRADËS

Bazamenti i gradës duhet të ketë strukturë tubolare. Në anën e pasme, tekstili duhet të jetë i përforcuar në të gjithë sipërfaqen e tij me shtresë polivinil kloruri (PVC). Ngjitja duhet bërë me anë të nxehtësisë. Shtresa përforcuese duhet të jetë e pashqitshme.

Pjesa e dukshme e gradës (për të gjithë rangjet) duhet të përshkohet gjatë gjithë perimetrit të saj (si kornizë). Korniza duhet të fiksohet me anë të procesit të termofiksimit. Ajo duhet të

jetë prej materiali plastik PVC me ngjyrë të kuqe të ndezur, me gjerësi 2.5 - 3 mm, trashësi 1.5 mm, të punuara në relief me vijëzime të pjerrëta me trashësi 1 mm.

Mbyllja e gradës duhet të bëhet nëpërmjet termofiksimit. Puthitja e dy anëve të tekstilit duhet të ketë gjerësi 1cm. Ngjitja duhet t'i rezistojë kohës dhe përdorimit të shpeshtë.

Më pas aplikohen me termofiksimit ose me qëndisje elementët e tjerë dekorativ të gradës në përputhje me rangun e gradës.



Korniza dhe elementët e gradës duhet të kenë sipërfaqe të pastër, të rregullt dhe pa deformime.



6. PUNIMI I ELEMENTËVE PLASTIKË

Elementët e gradës duhet të jenë prej materiali plastik me bazë PVC me ngjyrë të artë, të realizuar me teknikën e derdhjes së plastikës. Ato duhet të kenë sipërfaqe me shkëlqim, të punuar artistikisht me relief dekorativ. Materiali i derdhur PVC duhet të ketë ngjyrën përfundimtare. Elementët e lyer me spërkatje nuk do të pranohen. Elementët në gradë janë prodhuar në formatin 3D.

Vendosja e elementëve duhet të bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion (termofiksimit), në temperaturë të lartë mbi 120 gradë. Ngjitja e elementëve të plastikës duhet të jetë uniforme dhe homogjene për të siguruar rezistencën maksimale.


Korniza dhe elementët e gradës duhet të jenë të veshura me një shtresë të hollë plastike të tejdukshme mbrojtëse. Kjo shtresë duhet të jetë e pashqitshme. Ajo ruan efektin e punimeve të imëta, shkëlqimin e ngjyrave, sipërfaqen nga oksidimi që mund të shkaktojnë agjentët atmosferik, etj.

	Elementi 1: shiritat me thyerje >. Vija e thyer është me gjerësi 7 mm ± dhe me lartësi thyerje 17 mm ±. Ajo është e punuar me relief, me 3 "shirita" pa ndarje (2.5 mm - 2 mm - 2.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe në formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 2: Shiriti i drejtë i ngushtë në formë trapezi (7 mm ±) Shirit me gjerësi 7 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e këtyre shiritave duhet të jetë sa hapësira brenda kornizës anësore të kuqe në secilën pikë sipas lartësisë. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga tre "shirita" të drejtë pa ndarje (2.5 mm-2 mm-2.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe me formë cilindrike. Foto për referencë:

	Elementi 3: Shiriti i drejtë i ngushtë në formë drejtkëndore (7 mm ±) Shirit me gjerësi 7 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e shiritit është 46 mm. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga tre "shirita" të drejtë pa ndarje (2.5 mm-2 mm-2.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe me formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 4: Shiriti i drejtë i gjerë në formë trapezi (13 mm ±) Shirit me gjerësi 13 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e këtyre shiritave duhet të jetë sa hapësira brenda kornizës anësore të kuqe në secilën pikë sipas lartësisë. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga pesë "shirita" të drejtë pa ndarje (2.5 mm-2 mm-2.5 mm-2 mm-2.5 mm), 2 shiritat e mesit janë më të ngritur dhe me formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 5. Ylli i vogël (D=18 mm ±). Ylli dekorativ plastik me diametër 18 mm me ngjyrë të artë. Trashësia në qendër e yllit është 1.5 +/- 0.1 mm ndërsa në cepa 0.5 mm +/- 0.1 mm. Ylli është derdhur në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës. Ai është i punuar me relief dhe në sipërfaqen e tij ka disa gdhëndje e vijëzime në drejtim të qendrës dhe me një lidhje të kulmuar në qendër. Foto për referencë:
	Elementi 6. Ylli i mesëm (D= 20 mm ±). Ylli dekorativ plastik me diametër 20mm me ngjyrë të artë. Trashësia në qendër e yllit është 1.5 +/- 0.1 mm ndërsa në cepa 0.5 mm +/- 0.1 mm. Ylli është derdhur në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës. Ai është i punuar me relief dhe në sipërfaqen e tij ka disa gdhëndje e vijëzime në drejtim të qendrës dhe me një lidhje të kulmuar në qendër. Foto për referencë:

7. KOMPOZIMI I GRADAVE TE SPALETAVE SIPAS RANGUT

a. Shenja e spaletit shërbimi - *Student/ Kursant*




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5-3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë (7 mm x 46 mm ±)

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës. Mesi i shiritit të drejtë duhet të përkojë me aksin qendror të gradës.

Distanca e shiritit të drejtë të artë nga konturi i kuq duhet të jetë 4 mm ±.



b. Grada e spaletave të rangut – Inspektor




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 1 shirit i artë plastik, në formë >

Shiriti i artë i thyer me formë >, duhet vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Këmbët e shiritit > janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm 1\text{mm}$.



c. Grada e spaletave të rangut - *Inspektor i dytë*




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 2 shirita të artë plastike, në formë >>

Dy shirita të thyera me formë >> duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Distanca e shiritave nga njëri-tjetri duhet të jetë 3mm. Këmbët e shiritit > të parë janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm 1\text{mm}$.



d. Grada e spaletave të rangut – Inspektor i parë




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 3 shirita të artë plastikë, në formë >>>

Tre shirita të thyera me formë >>> duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Distanca e shiritave nga njëri-tjetri duhet të jetë 3 mm. Këmbët e shiritit > të parë janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



e. Grada e spaletave të rangut - Nënkomisar




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 -3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë (7 mm ±)
- 1 (një) yll me 5 cepa me diametër 18 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës.

Ylli dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 18mm, pozicionohet sipas skemës në qendër, në distancë rreth 11 mm± nga shiriti i drejtë tek qendra e yllit.



f. Grada e spaletave të rangut – Komisar




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë (7 mm ±)
- 2 (dy) yje me 5 cepa me diametër 18 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës.

2 Yjet dekorativë plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 18mm, pozicionohen sipas skemës në qendër, me distancë rreth 11 mm ± nga shiriti i drejtë tek qendra e yjeve. Pozicionohet sipas skemës, nga shiriti i drejte 11 mm tek qendra e yllit dhe të barazlanguara me 15 mm nga konturi i kuq. Distanca ndermjet tyre, e qendrave të yjeve eshte 20 mm.



g. Grada e spaletave të rangut - Kryekomisar




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë (7 mm ±)
- 3 (tre) yje me 5 cepa me diametër 18 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjerë të gradës.

3 Yjet dekorativë plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 18mm, pozicionohen sipas skemës në qendër, me distancë rreth 11 mm± nga shiriti i drejtë tek qendra e yjeve. Pozicionohet sipas skemës, nga shiriti i drejtë 11 mm tek qendra e yllit dhe të barazlanguara me 15 mm nga konturi i kuq. Distanca ndërmjet tyre, e qendrave të yjeve është 20 mm. Ylli i tretë pozicionohet në qendër të aksit të gradës me distancë të qendrës së yllit nga shiriti plastik i drejtë 27 mm.



h. Grada e spaletave të rangut - Drejtues




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik të drejtë i gjere (13 mm $\pm$)
- 1 (një) yll i mesëm me 5 cepa me diametër 20 mm.

Shiriti i drejtë i gjere duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjere të gradës.

Ylli dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 20mm, pozicionohet sipas skemës, në aksin qendror të gradës i barazlanguar nga konturi i kuq. Qendra e yllit ka distancë 14 mm nga shiriti i drejtë.



i. Grada e spaletave të rangut - Drejtues i parë




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5-3 mm)
- 1 (një) shirit plastik të drejtë i gjere (13 mm ±)
- 2 (një) yje të mesëm me 5 cepa me diametër 20 mm.


Shiriti i drejtë i gjere duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjere të gradës.

2 Yjet dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 20 mm, pozicionohen sipas skemës, nga shiriti i drejtë me distancë 14 mm tek qendra e yjeve. Krahët e yjeve janë të barazlarguara me 4 mm nga konturi i kuq.



PUNIMI I ELEMENTEVE TË QËNDISUR TË GRADËS


Elementi 1: Shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari




Qëndisje me shufra metali të vogla



Skema e mbivendosjes se elementeve




Elementi 2: Ylli me diametër 22 mm



Qëndisja e yllit është me relief dhe me trashësi: në cepat 0,5 mm dhe në qendër 2mm. Ylli është qëndisur në relief, në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës.

j. Grada e spaletave të rangut - Drejtues i lartë




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 105 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5-3 mm)
- 1 (një) shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari (gjerësi 23 mm $\pm$)
- 1 (një) yll i qëndisur, i madh me 5 cepa (d.22 mm)

Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjerë të gradës.

Mbi të pozicionet një yll i qëndisur me distancë 15 mm nga shiriti i qëndisur tek qendra e yllit. Ylli është pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të barazlanguara.



k. Grada e spaletave të rangut - Drejtues madhor




Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 105 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5-3 mm)
- 1 (një) shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari (gjerësi 23 mm ±)
- 2 (dy) yje të qëndisur, i madh me 5 cepa (d.22 mm)

Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjerë të gradës.

Mbi të pozicionohen dy yje të qëndisur me distancë 15 mm nga shiriti i qëndisur tek qendra e yllit. Ylli është pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të barazlanguara. Yjet kanë nga një distancë 2 mm nga njëri-tjetri dhe 2 mm nga korniza e kuqe plastike.



8. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element përbërës të gradës si p.sh.: përshtatshmëria e materialeve të përdorura, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj
- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Të gjithë elementët e gradës duhet të jenë simetrikë
- Tekstili dhe elementët e tjerë plastikë të gradës duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet
- Në të gjitha dimensionet do të pranohet një tolerancë prej ± 1 mm.
- Produkti përfundimtar duhet të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, përkuljeve, elementëve atmosferik, etj.
- Gjithashtu nga përkulja e lehtë, disa herë e produktit, nuk duhet të shfaqen thyerje apo vrima të vogla.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006

Kujdes! Gradat duhet të punohen me kujdes të veçantë dhe elementët duhet të rezultojnë pa defekte e parregullsi. Në veçanti nuk duhet të shfaqin (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Kokërzim (punime të ashpra), ç'fijeime ose konturime të parregullta në bazament.
- Diferencë ngjyre dhe tonaliteti ndërmjet tyre në bazament.
- Deformime të produkteve të të njëjtit lloj.
- Ndryshim në dendësi dhe ashpërsi të materialit.
- Mospërputhje mes çifteve të gradave.
- Deformime të konfiguracioneve dhe shkëputje të pjesëve, gropëzime ose plasaritje.
- Relieve të plota e jo të rregullta.
- Mungesë të ngjitjes së fletës plastike të tejdukshme.
- Pjesë të pasalduara ose jo plotësisht të salduara.
- Shkëputje të pjesëve të kornizës.
- Dhe çdo parregullsi tjetër që cënon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

9. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Gradat duhet të jenë të paketuara çift (një e djathtë dhe një e majtë) të ndara sipas rangjeve. Secili çift duhet të mbështillet me një letër të hollë dhe të vendoset në një qese transparente polietileni bashkë me emërtimin e gradës psh: *Grada për rangun Drejtues i Lartë*.

Qeset me gradat vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me adeziv (ngjitës) dhe mbi kuti të jenë të shënuara udhëzimet e mëposhtme (të stampuara ose të vendosura në etiketat me letër ngjitëse):

- udhëzimet e produktit;
- numri i gradave;

- viti i prodhimit;
- emri i kompanisë furnizuese me vulën përkatëse;

Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të mbyllën me ngjitës që sigurohet mbyllja e mirë.

Kartoni (me peshë rreth 600 gr/m²) i kutive duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve.

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Për tekstilin e bazamentit të gradës	
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
pH	EN ISO 3071:2006
Azo ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
Për elementët plastikë	
Përbërja	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	

Për produktin e gatshëm	
Rezistenca ndaj përkuljes dhe fërkimit.	Në palosjen e bazamentit të gradës nuk duhet të shfaqen prishje, plasaritje, humbje ngjyrash, gropëzime dhe deformime të vazhdueshme.
Rezistenca ndaj ujit	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25° C $\pm$ 2.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion <i>sapun marseje</i> 3% në 25°C.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool etilik e më pas me benzinë.
Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në solucionin e klorurit të sodiumit në 1% në 25°C
Kontrolli i prezencës së fletës mbrojtëse të tejdukshme plastike tek elementët plastikë.	Kampioni do të zhytet për pak sekonda në klorur metileni puro dhe pastaj do të shpëlahet me ujë. Nëse ekziston fleta plastike mbrojtëse e tejdukshme ajo do të shqitet lehtësisht. Tejdukshmëria e shtresës mbrojtëse dallohet dhe nën veprimet e forta mekanike.

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

Gradat e vogla të gjoksit të Policisë së Shtetit sipas rangut Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit

HYRJE

“Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit” në pjesën e pasme kanë të fiksuar “velcro mashkull”. Ato janë lehtësisht të montueshme dhe të çmontueshme në uniformat përkatëse, pasi në to është aplikuar një velcro femër me po të njëjtat përmasa.

“Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit” duhet të prodhohen me materialet dhe format e kërkuara nga Policia e Shtetit. Ato duhet të prodhohen në bazë të pamjes së jashtme, modelit, përmasave dhe ngjyrave të përcaktuara në këtë dokument.

		
Inspektor	Inspektor i dytë	Inspektor i parë

		
Nënkomisar	Komisar	Kryekomisar
		
Drejtues	Drejtues i parë	Drejtues i lartë
		
Drejtues madhor	Shenjë student/ kursant	Numri i Identifikimit
		
Shenja e Mbiemrit		

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKUJVE

"Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit"

1. MATERIALET

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit *Gradat e vogla të gjoksit, numri i identifikimit dhe shenja e mbiemrit* ndahen në:

- Materiali i bazamentit
 - Elementët dekorativë në PVC (polivinil kloruri) dhe të qëndisur
- a. Materiali i bazamentit duhet të jetë tekstil ngjyrë blu i errët, i cilësisë së I-rë, që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet. Materiali i përdorur duhet të jetë rezistent ndaj efektit të agjentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës. Materiali i bazamentit duhet të ketë këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja % (± 5%)	50% Lesh	50 % Poliester

Thurja	Diagonale e dërstiluar	
Masa gr/m ² (± 5%)	220gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 4500 cikle	
pH	4-9	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- velkro-të, nuk duhet t'u dalin fije përgjatë anëve të lira të shiritit si në velkro "mashkull" ashtu dhe në atë "femër" edhe pasi të jetë përsëritur disa herë montimi dhe ç'montimi i dy pjesëve të saj.
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Elementët dhe materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit "Gradat e vogla të gjoksit, numri i identifikimit dhe shenja e mbiemrit" janë :

Elementë plastikë

Elementë dekorativë plastikë që vendosen brenda gradës si Korniza, yjet, shiritat, shkronjat, numrat	Përbërje	100% Polivinil Kloruri PVC	
	Ngjyra	E artë dhe e kuqe	
Shirit Velcro Mashkull			
Shirit velcro mashkull për vendosjen e gradës, numrit të identifikimit ose shënjës së mbiemrit në veshje.	Përmasat		86 mm x 30 mm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		1.6 mm
	Masa lineare		40 g/m ±3%
	Ngjyra		Blu e errët
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
		pika e shkrirjes	210 – 250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje		jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Fill për qepje			
Fill për qepjen e shiritit velcro mashkull me tekstin	Përbërja		100% poliestër
	Numri metrik		120 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje		jo më pak se 12N
	Ngjyra		Blu e errët
Tekstil			
Shirit prej tekstili për gradat e Drejtuesve të Lartë dhe Madhor.	Përbërja		100 % Mëndafsh
	Ngjyra		E artë
Fije metalike			
Fill metalik për qëndisjen e elementëve të gradave të Drejtuesve të Lartë dhe Madhor	Përbërja		Metalike
	Ngjyra		E artë
Shufra metalike			
Shufra të holla prej metali me dy forma të ndryshme	Përbërja		Metalike
	Ngjyra		e artë
	Forma	tubolare	sustë

Të gjithë këto elementë dhe aksesorë, mund të zëvendësohen me material të ngjashëm, vetëm nëse kanë karakteristika të barabarta dhe/ose të përmirësuara, që t'i përgjigjen plotësisht specifikave të kërkuara për prodhimin e produktit.


KUJDES! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *grada të vogla të gjoksit, numrit të identifikimit dhe shenjës së mbiemrit:*

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietilene që mbyllet me ngjitje për paketimin e 3 copë gradash	1 letër e hollë për paketimin e 3 copë gradave, 3 copë numër identifikimi, 3 copë shenja mbiemri
1 kuti kartoni për paketimin e 60 sete gradash	

2. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu për bazën e gradës sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349.

Ngjyra e kuqe për kornizën anësore sipas spektrit CIELCH 41, 70.780, 28.754

Ngjyra e artë për elementët plastikë, elementët me qëndisje dhe tekstin prej mëndafshi sipas spektrit CIELCH 72, 63.619, 74.057.

Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyrat referuese për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të lëndës së parë tekstil dhe kampionëve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

3. PËRMASAT

Bazamenti i “Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit” janë të treja, në formë drejtkëndëshi me përmasa 86 mm x 30 mm.

Kujdes! Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

4. SASIA E PRODHIMIT

Artikujt “Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit” duhet të prodhohen sipas sasisë së specifikuar nga porositësi. Prodhuksi ka për detyrë që të parashikojë prodhimin e kësaj sasive saktësisht sipas specifikimeve të porositësit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I BAZAMENTIT TË GRADËS

Bazamenti i gradës, numrit dhe shenjës së mbiemrit është në formë drejtkëndore. Bazamenti duhet që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet. Materiali i përdorur duhet të jetë rezistent ndaj efektit të agjentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës.

Për montimin në veshje të gradës, numrit të identifikimit dhe shenjës së mbiemrit, aplikohet në pjesën e prapme një velcro mashkull. Velcro-të priten me përmasa të njëjta 86 mm x 30 mm dhe aplikohen në bazamentin e drejtkëndëshit prej tekstili me anë të termofiksimit dhe pastaj të qepjes me fill me të njëjtin tonalitet me tekstilin.

Pjesa e dukshme e gradës (për të gjithë rangjet), numrit dhe shenjës së mbiemrit, duhet të përshkohet gjatë gjithë perimetrit të saj me një kornizë të kuqe të ndezur. Ajo duhet të jetë prej materiali plastik PVC, me gjerësi 2.5 – 3 mm, trashësi 1 mm, e punuar në reliev me vijëzime të pjerrëta me trashësi 1 mm. Korniza duhet të fiksohet me anë të procesit të termofiksimit. Korniza e kuqe e duhet të vendoset pasi të jetë përfunduar procesi i qepjes së tekstilit me velcro. Ngjitja duhet të jetë e fortë e ti rezistojë përdorimit. Grada nuk duhet të hapet ose shqitet.

Korniza dhe elementët duhet të kenë sipërfaqe të pastër, elementët të jenë me pamje të rregullt dhe pa deformime.



6. PUNIMI I ELEMENTËVE PLASTIKË

Elementët e gradës duhet të jenë prej materiali plastik me bazë polivinil kloruri PVC me ngjyrë të artë. Ato duhet të kenë sipërfaqe me shkëlqim, të punuar artistikisht me reliev dekorativ. Materiali i derdhur PVC duhet të ketë ngjyrën përfundimtare. Elementët e lyer me spërkatje nuk do të pranohen.

Elementët plastikë janë realizuar me teknikën e derdhjes së plastikës. Vendosja e elementëve në *gradë* dhe e bashkimit të gradës me velcron mashkull duhet të bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion (termofiksion) në temperaturë të lartë mbi 120 gradë. Ngjitja e elementëve të plastikës duhet të jetë uniforme dhe homogjene për të siguruar rezistencën maksimale.

Për shënjën e mbiemrit dhe Nr e Identifikimit realizimi i elementëve duhet të bëhet me formatin 3D. Numrat për *numrin e identifikimit* dhe gërmat e *shenjës së mbiemrit* aplikohen me stampim në të nxehtë dhe presion.

Korniza dhe elementët e gradës duhet të jenë të veshura me një shtresë të hollë plastike të tejdukshme mbrojtëse. Kjo shtresë duhet të jetë e pashqitshme. Ajo ruan efektin e punimeve të imëta, shkëlqimin e ngjyrave, sipërfaqen nga oksidimi që mund të shkaktojnë agjentët atmosferik, etj.

	Elementi 1: shiritat me thyerje ^. Vija e thyer është me gjerësi 4 mm ± dhe me lartësi thyerje 10 mm ±. Ai është i punuar me relief, me 3 "shirita" pa ndarje (1.5mm -1mm- 1.5mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe në formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 2: shiritat me thyerje ^. Vija e thyer është me gjerësi 3 mm ± dhe me lartësi thyerje 7 mm ±. Ai është i punuar me relief, me 3 "shirita" pa ndarje (1 mm - 1 mm - 1 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe në formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 3: Shiriti i drejte i ngushtë në formë drejtkëndore (4 mm ±) Shirit me gjerësi 4 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e shiritit është 38mm. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga tre "shirita" të drejtë pa ndarje (1.5 mm - 1 mm - 1.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe me formë cilindrike. Foto për referencë:
	Elementi 4: Shiriti i drejte i gjerë në formë drejtkëndore (6 mm ±) Shirit me gjerësi 6 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e shiritit është 40 mm. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga pesë "shirita" të drejtë pa ndarje (1.3mm-1mm-1.3mm-1mm-1.3mm), 2 shiritat e mesit janë më të ngritur dhe me formë cilindrike. Foto për referencë:

	Elementi 5. Ylli i vogël ($D = 13 \text{ mm} \pm$). Ylli dekorativ plastik me diametër 13mm me ngjyrë të artë. Trashësia në qendër e yllit është $1.5 \pm 0.1 \text{ mm}$ ndërsa në cepa $0.5 \text{ mm} \pm 0.1 \text{ mm}$. Ylli është derdhur në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës. Ai është i punuar me relief dhe në sipërfaqen e tij ka disa gdhëndje e vijëzime në drejtim të qendrës dhe me një lidhje të kulmuar në qendër. Foto për referencë:
	Elementi 6. Ylli i mesëm ($D = 15 \text{ mm} \pm$). Ylli dekorativ plastik me diametër 15mm me ngjyrë të artë. Trashësia në qendër e yllit është $1.5 \pm 0.1 \text{ mm}$ ndërsa në cepa $0.5 \text{ mm} \pm 0.1 \text{ mm}$. Ylli është derdhur në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës. Ai është i punuar me relief dhe në sipërfaqen e tij ka disa gdhëndje e vijëzime në drejtim të qendrës dhe me një lidhje të kulmuar në qendër. Foto për referencë:

7. KOMPOZIMI I GRADAVE SIPAS HIERARKISË DHE SHENJAVE

a. Shenjë e vogël gjoksi - *Student/ Kursant*



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86 mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë në formë drejtkëndore (4 mm x 38mm)

Shiriti i drejtë duhet të pozicionohet $3 \text{ mm} \pm$ mbi konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlarguar nga skajet.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm 1 \text{ mm}$.

b. Grada e vogël gjoksi e rangut – Inspektor



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione $86 \text{ mm} \times 30 \text{ mm}$. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi ($2.5 - 3 \text{ mm}$)
- 1 shirit i thyer i artë plastik në formë $\wedge$ me gjerësi 4 mm .

Shiriti i artë i thyer me formë $\wedge$, duhet vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim të kulmit lart. Kulmi i shiritit $\wedge$ duhet të jetë i pozicionuar në mes të drejtkëndëshit dhe këmbët e tij $\wedge$ janë pozicionuar 2 mm mbi konturin e kuq.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm 1 \text{ mm}$.

c. Grada e vogël gjoksi e rangut – Inspektor i dytë



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione $86 \text{ mm} \times 30 \text{ mm}$. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi ($2.5 - 3 \text{ mm}$)
- 2 shirita të thyer të artë plastik në formë $\wedge$ me gjerësi 4 mm .

Dy shirita të thyer me formë $\wedge$, duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim të kulmit lart. Kulmi i shiritave $\wedge$ duhet të jetë i pozicionuar në mes të drejtkëndëshit dhe

këmbët e shiritit ^ të parë janë pozicionuar 2 mm mbi konturin e kuq. Distanca nga njëri - tjetri është 1 mm ±.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

d. Grada e vogël gjoksi e rangut – Inspektor i parë



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86 mm x 30 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 – 3 mm)
- 3 shirita të thyer të artë plastik në formë ^ me gjerësi 3 mm.

Tre shirita të thyer me formë ^, duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim të kulmit lart. Kulmi i shiritave ^ duhet të jetë i pozicionuar në mes të drejtkëndëshit dhe këmbët e shiritit ^ të parë janë pozicionuar 2 mm mbi konturin e kuq. Distanca nga njëri shirit te tjetri është 2 mm ±.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

e. Grada e vogël gjoksi e rangut - Nënkomisar



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 – 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i ngushtë (4 mm x 38 mm)
- 1 (një) yll plastik me 5 cepa me diametër 13 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlanguar nga skajet.

Ylli dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 13mm, pozicionohet sipas skemës në qendër, në distancë rreth 7 mm $\pm$ nga shiriti i drejtë tek qendra e yllit.

Bazamenti të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm$ 1 mm.

f. Grada e vogël gjoksi e rangut - Komisar



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik të drejtë i ngushtë (4 mm x 38 mm)
- 2 (dy) yje me 5 cepa me diametër 13 mm $\pm$

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlanguar nga skajet.

Yjet dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 13 mm, pozicionohen sipas skemës në distancë rreth 7 mm $\pm$ nga shiriti i drejtë te qendra e yllit dhe 32 mm nga konturi i kuq. Distanca e qendrave të dy yjeve është 15 mm $\pm$.

Bazamenti të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm$ 1 mm.

g. Grada e vogël gjoksi e rangut - Kryekomisar



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86 mm x 30 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik të drejtë i ngushtë (4 mm x 38 mm)
- 3 (tre) yje me 5 cepa me diametër 13 mm $\pm$

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlanguar nga skajet.

Yjet dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 13mm, pozicionohen sipas skemës në distancë rreth 7 mm ± nga shiriti i drejtë te qendra e yllit. Distancat e qendrave të yjeve janë 15 mm ±. Qendrat e dy yjeve anësorë janë pozicionuar 25 mm nga kornizat e kuqe.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

h. Grada e vogël gjoksi e rangut - Drejtues



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i gjerë (6 mm x 40 mm)
- 1 (një) yll me 5 cepa me diametër 15 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlanguar nga skajet.

Ylli dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 15mm, pozicionohet sipas skemës në distancë rreth 7 mm ± nga shiriti i drejtë te qendra e yllit.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

i. Grada e vogël gjoksi e rangut- Drejtues i parë



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 - 3mm)
- 1 (një) shirit plastik i drejtë i gjerë (6 mm x 40 mm)
- 2 (dy) yje me 5 cepa me diametër 15 mm ±

Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal dhe i barazlarguar nga skajet.


Yjet dekorativ plastik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 15 mm, pozicionohen sipas skemës në distancë rreth 7 mm $\pm$ nga shiriti i drejtë te qendra e yllit dhe 31 mm nga konturi i kuq. Distanca të qendrave ndërmjet yjeve është 17 mm $\pm$.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksimit dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

PUNIMI I ELEMENTËVE TË QENDISUR TË GRADËS

Elementi 1: Shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari



Elementi 2: Ylli me diametër 17 mm



Qëndisja e yllit është me relief dhe me trashësi: në cepat 1,5 mm dhe në qendër 2,5 mm. Ylli është qendisur në relief, në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës.

Elementët aplikohen me qëndisje të elementëve dekorativë në përputhje me rangun e gradës.

j. Grada e vogël gjoksi e rangut - Drejtues i lartë



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 – 3 mm)
- 1 shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyre ari (10 mm x 80 mm ±)
- 1 yll i qëndisur me 5 cepa (d.17 mm)

Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal.

Në mes të gradës është ndërthurur së bashku me shiritin dekorativ një yll me diameter 17 mm, me ngjyrë të artë i punuar në relief me anë të shufrash të holla metalike. Këmbët e yllit janë të pozicionuar mbi shiritin qendror që e ndan motivin e qilimit në mes dhe është pozicionuar në mënyrë të barazlarguar nga kornizat anësore të kuqe.

Vendosja e elementeve në gradë, është bërë me anë të qendisjes së shufrave të holla metalike ngjyrë ari.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksimit dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

k. Grada e vogël gjoksi e rangut - Drejtues madhor



Bazamenti i gradës është në formë drejtkëndëshi me dimensione 86mm x 30mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 – 3 mm)
- 1 shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyre ari (10 mm x 80 mm ±)

- 2 yje të qëndisur me 5 cepa (d.17 mm)

Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik në drejtim horizontal.

Në mes të gradës janë ndërthurur së bashku me shiritin dekorativ dy yje me diametër 17 mm, me ngjyrë të artë të punuar në relief me anë të shufrash të holla metalike. Këmbët e yjeve janë të pozicionuar mbi shiritin qendror që e ndan motivin e qilimit në mes dhe janë pozicionuar në mënyrë të barazlanguar nga kornizat anësore të kuqe.


Distanca ndërmjet krahëve të yjeve është 4 mm $\pm$. Distanca e krahut të majtë dhe të djathtë të yllit nga korniza anësore e kuqe është respektivisht 21mm $\pm$.

Vendosja e elementeve në gradë, është bërë me anë të qendisjes së shufrave të holla metalike ngjyrë ari.

Bazamentit të gradës i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velcro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është $\pm$ 1 mm.

➤ Numri i Identifikimit



Numri i identifikimit është i personalizuar për çdo punonjës të Policisë së Shtetit. Bazamenti i tij është në formë drejtkëndore, me përmasa 86 mm x 30 mm. Në pjesën e sipërme të tij duhet të vendosen elementët:

- 1 (një) kornizë e kuqe, plastike në formë drejtkëndore (2.5 - 3 mm)
- *Numri i identifikimit*, i cili është unik për çdo punonjës policie.

Numri i identifikimit përbëhet nga 5 shifra, të punuara me material plastik, me ngjyrë të artë të punuar në relief, me të dhënat e mëposhtme:

- Lloji i shkrimit "Myriad Pro Bold"
- Lartësi e shifrave 14 mm ±

Vendosja e elementëve plastike të bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion. Shifrat janë të barazalarguara nga konturet anësore dhe 5 mm ± mbi kornizën e kuqe. Ato duhet të jenë sa më preçize dhe të rregullta.

Bazamentit të *numrit të identifikimit* i bashkangjitet me termofiksimit dhe pastaj me qepje velkro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi, e nevojshme për fiksimin e numrit në uniforme.

Punimi i numrit të identifikimit nuk bëhet në seri, por është i personalizuar. Duhet patur kujdes në montimin e çdo shifre në numrin e identifikimit, në mënyrë që të mos gabohet.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve është ± 1 mm.

➤ Shenja e mbiemrit



Shenja e mbiemrit është e personalizuar për çdo punonjës të Policisë së Shtetit. Bazamenti i shenjës së mbiemrit është në formë drejtkëndore, me përmasa 86 mm x 30 mm. Në pjesën e sipërme të tij duhet të vendosen elementët:

- 1 kornizë e kuqe plastike me formë drejtkëndëshi (2.5 – 3 mm)
- Mbiemri i punonjesit/punonjësës të Policisë së Shtetit

Shenja e mbiemrit duhet të jetë e punuar me material plastik e me relief, me ngjyrë të artë me të dhënat e mëposhtme:

- Shkronja kapitale shtypi
- Tipi i shkrimit "Myriad Pro Bold"
- Lartësi e shkrimit 14 mm ±
- Madhësia e shkrimit duhet të jetë e ndryshueshme proporcionalisht, në varësi të mbiemrit të punonjesit.

Vendosja e elementëve plastike të bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion. Shkronjat e mbiemrit janë të barazalarguara nga konturet anësore dhe 5 mm ± mbi kornizën e kuqe. Ato duhet të jenë sa më preçize dhe të rregullta.

Duhet patur kujdes në montimin e çdo shkronje në shenjën e mbiemrit, në mënyrë që të mos gabohet.

Bazamentit të shenjës së mbiemrit i bashkangjitet me termofiksim dhe pastaj me qepje velkro mashkull (ngjitësin), në po të njëjtën formë e madhësi, e nevojshme për fiksimin e mbiemrit në uniforme.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve është ± 1 mm.

8. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element përbërës të gradës si p.sh.: përshtatshmëria e materialeve të përdorura, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj
- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Të gjithë elementët e gradës duhet të jenë simetrikë
- Tekstili dhe elementët e tjerë plastikë të gradës duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet
- Në të gjitha dimensionet do të pranohet një tolerancë prej ± 1 mm.
- Produkti përfundimtar duhet të jetë rezistent ndaj gërvishjeve, përkuljeve, elementëve atmosferik, etj.
- Gjithashtu nga përkulja e lehtë, disa herë e produktit, nuk duhet të shfaqen thyerje apo vrima të vogla.
- Nuk duhet të vihen re ç'fijëzime përgjatë anëve të lira të shiritit velcro "mashkull" pas disa operacionesh të përsëritura të montimit dhe ç'montimit të të dy pjesëve.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006

Kujdes! Gradat duhet të punohen me kujdes të veçantë dhe elementët duhet të rezultojnë pa defekte e parregullsi. Në veçanti nuk duhet të shfaqin (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Kokërzim (punime të ashpra), ç'fijëzime ose konturime të parregullta në bazament.
- Diferencë ngjyre dhe tonaliteti ndërmjet tyre në bazament.
- Deformime të produkteve të të njëjtit lloj.
- Ndryshim në dendësi dhe ashpërsi të materialit.
- Deformime të konfiguracioneve dhe shkoputje të pjesëve, gropëzime ose plasaritje.
- Relieve të plota e jo të rregullta.
- Mungesë të ngjitjes së fletës plastike të tejdukshme.
- Pjesë të pasalduara ose jo plotësisht të salduara.
- Shkoputje të pjesëve të kornizës.
- Shqitje të numrit të identifikimit apo shkronjave nga bazamenti
- Dhe çdo parregullsi tjetër që cënon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

9. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Gradat e vogla të gjoksit, shenja e mbiemrit dhe numri i identifikimit duhet të vendosen të ndara sipas rangjeve. Secili element duhet të mbështillet me një letër të hollë dhe të vendoset

në një qese transparente polietileni bashkë me emërtimin. Brenda qeseve duhet të futen nga 3 copë grada, 3 copë nr Identifikimit RIMS dhe 3 shenja të mbiemrit.

Qeset vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me anën e një shiriti adeziv (ngjitës) dhe gjithashtu duhet të jenë shënuar udhëzimet e mëposhtme (të stampuara ose të vendosura në etiketat me letër ngjitëse) :

- udhëzimet e produktit;
- numri i gradave; numrave RIMS dhe Mbiemrat
- viti i prodhimit;
- emri i kompanisë furnizuese me vulën përkatëse;

Nga jashtë kutive duhet të shkruhen në etiketat nr RIMS që janë paketuar në atë kuti dhe po ashtu me mbiemrat.

Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të mbyllen me ngjitës duke siguruar mbyllje të mirë. Kartoni (me peshë rreth 600 gr/ m²) i kutive duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurtë të produkteve.

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Për tekstilin e bazamentit të gradës	
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me

	llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
pH	EN ISO 3071:2006
Azo ngjyruet	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
Për elementët plastikë	
Përbërja	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	
Për produktin e gatshëm	
Rezistenca ndaj përkuljes dhe fërkimit.	Në palosjen e bazamentit të gradës, shenjës së mbiemrit dhe nr të identifikimit nuk duhet të shfaqen prishje, plasaritje, humbje ngjyrash, gropëzime dhe deformime të vazhdueshme.
Rezistenca ndaj ujit	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë $25^{\circ}\text{C} \pm 2$.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion <i>sapun marseje</i> 3% në 25°C .
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool etilik e më pas me benzinë.
Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në solucionin e klorurit të sodiumit në 1% në 25°C
Kontrolli i prezencës së fletës mbrojtëse të tejdukshme plastike tek elementët plastikë.	Kampioni do të zhytet për pak sekonda në klorur metileni puro dhe pastaj do të shpëlahet me ujë. Nëse ekziston fleta plastike mbrojtëse e tejdukshme ajo do të shqitet lehtësisht. Tejdukshmëria e shtresës mbrojtëse dallohet dhe nën veprimet e forta mekanike.

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit sipas rangut

HYRJE

"Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit" për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të vendosen lart në të dyja supet të çdo artikulli të uniformës që kanë spaleta për vendosjen e tyre.

Gradat dhe elementët saj dekorativ duhet të prodhohen me materialet dhe format e kërkuara nga Policia e Shtetit. Ato duhet të prodhohen në bazë të pamjes së jashtme, modelit, përmasave dhe ngjyrave të përcaktuara në këtë dokument.

 Inspektor	 Inspektor i dytë	 Inspektor i parë
 Nënkomisar	 Komisar	 Kryekomisar
 Drejtues	 Drejtues i Parë	 Drejtues i Lartë

 Drejtues Madhor	 Shenja Student/kursant	
---	--	--

TE DHENAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKUJVE

"Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit"

1. MATERIALET

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit *"Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit"* janë:

- c. Materiali i bazamentit
 - d. Elementët dekorativë metalikë dhe të qëndisur
- a.** Materiali i bazamentit duhet të jetë tekstil ngjyrë blu i errët, i cilësisë së I-rë, i përforcuar nga brenda me silikon i cili bën bashkimin me një shtresë polivinil kloruri (PVC) që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet. Materiali i përdorur duhet të jetë

rezistent ndaj efektit të agentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës. Materiali i bazamentit duhet të ketë këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja % ($\pm 5\%$)	50% Lesh	50 % Poliester
Thurja	Diagonale e dërstiluar	
Masa gr/m ² ($\pm 5\%$)	220gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 4500 cikle	
pH	4-9	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jete te pranishem	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstit duhet të jetë: *e qëndrueshme - nota 4 dhe shumë e qëndrueshme - nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se - nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet tek tekstili i bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Elementët dhe materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit “Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit” janë :

Elementë plastikë			
Korniza: element dekorativë plastik që vendoset brenda gradës	Përbërje	100% Polivinil Kloruri PVC	
	Ngjyra	E kuqe	
Elementë metalikë			
Elementë dekorativë metalikë që vendosen brenda gradës (shirita, yje, përkrenarja e Skënderbeut e stilizuar)	Përbërje ± 3%	97% Zink (Zn)	3% Alumin (Al)
	Cilësia e I-rë, i pandryshkshëm		
	Ngjyra	E artë	
Tekstil			
Shirit prej tekstili për gradat e Drejtuesve të Lartë dhe Madhor.	Përbërja	100 % Mëndafsh	
	Ngjyra:	E artë	
Fije metalike			
Fill metalik për qëndisjen e elementëve të gradave të Drejtuesve të Lartë dhe Madhor	Përbërja:	Metalike	
	Ngjyra	E artë	
Shufra metalike			
Shufra të holla prej metali me dy forma të ndryshme	Përbërja:	Metalike	
	Ngjyra:	e artë	
	Forma	tubolare	sustë

Të gjithë këto elementë dhe aksesore, mund të zëvendësohen me material të ngjashëm, vetëm nëse kanë karakteristika të barabarta dhe/ose të përmirësuara, që t’i përgjigjen plotësisht specifikave të kërkuara për prodhimin e produktit.

KUJDES! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *grada të mëdha Ceremoniale*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietilene që mbyllet me ngjitje për paketimin e një palë grada	1 letër e hollë për paketimin e një palë gradave
1 kuti kartoni për paketimin e 60 cifte gradash	

2. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu për bazën e gradës sipas spektrit CIELCH **18, 14.587, 295.349**.

Ngjyra e kuqe për kornizën anësore sipas spektrit CIELCH **41, 70.780, 28.754**

Ngjyra e artë për elementët metalikë, elementët me qëndisje dhe tekstilin prej mëndafshi sipas spektrit CIELCH **72, 63.619, 74.057**.

Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyra që prodhuesi duhet t'i ketë si referencë. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

3. PËRMASAT E GRADAVE

Bazamenti i gradës ka pamje të sipërme trapezoidale dhe duhet të ketë këto përmasa:

- nga rangu *Inspektor* deri tek rangu *Drejtues i Parë* gjatësia e gradës duhet të jetë 90 mm ndërsa gjerësia e trapezit - 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël;
- për rangjet *Drejtues i Lartë* dhe *Drejtues Madhor* gjatësia e gradës duhet të jetë 105 mm ndërsa gjerësia e trapezit - 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël.

Kujdes!!! Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

4. SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit* duhet të prodhohen në çifte, sipas sasisë së specifikuar nga porositësi. Prodhuesi ka për detyrë që të parashikojë prodhimin e kësaj sasive saktësisht sipas specifikimeve të porositësit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I BAZAMENTIT TË GRADËS

Bazamenti i gradës duhet të ketë strukturë tubolare. Në anën e pasme, tekstili duhet të jetë i përforcuar në të gjithë sipërfaqen e tij me shtresë polivinil kloruri (PVC). Ngjitja duhet bërë me anë të nxehtësisë. Shtresa përforcuese duhet të jetë e pashqitshme.

Pjesa e dukshme e gradës (për të gjithë rangjet) duhet të përshkohet gjatë gjithë perimetrit të saj (si kornizë). Korniza duhet të fiksohet me anë të procesit të termofiksimit. Ajo duhet të jetë prej materiali plastik PVC me ngjyrë të kuqe të ndezur, me gjerësi 2.5 - 3 mm, trashësi 1.5 mm, të punuara në relief me vijëzime të pjerrëta me trashësi 1 mm.

Mbyllja e gradës duhet të bëhet nëpërmjet termofiksimit. Puthitja e dy anëve të tekstitit duhet të ketë gjerësi 1cm. Ngjitja duhet t'i rezistojë kohës dhe përdorimit të shpeshtë.

Më pas aplikohen me anë të filetove ose me qëndisje elementët e tjerë dekorativ të gradës në përputhje me rangun e gradës.


Korniza dhe elementët e gradës duhet të kenë sipërfaqe të pastër, të rregullt dhe pa deformime.

6. PUNIMI I ELEMENTËVE METALIKE

Elementët e gradës duhet të jenë me material metalik, me ngjyrë të artë, të shndritshme dhe të punuara artistikisht në relief. Elementët metalike janë realizuar me teknikën e derdhjes së metalit, duke ruajtur punimet e imëta të modelit dhe shkëlqimin. Elementët në gradë janë prodhuar në formatin 3D.



Vendosja e elementëve në gradë bëhet me anën e filetove. Pjesa e filetos është realizuar me anë të saldimit në pjesën e prapme. Elementët si shiritat dhe përkrenarja e Skënderbeut kanë nga dy fileto montimi të barazlanguara. Ylli ka vetëm një fileto montimi, të sladuar në qendër prapa. Filetot e montimit duhe të jenë rezistente gjatë përdorimit dhe nuk duhet të shpëputen nga elementët e gradave.

Korniza duhet të jetë e veshur me një shtresë të hollë plastike të tejdukshme mbrojtëse. Kjo shtresë duhet të jetë e pashqitshme. Ajo ruan efektin e punimeve të imëta, shkëlqimin e ngjyrave, sipërfaqen nga oksidimi që mund të shkaktojnë agjentët atmosferik, etj.



Elementi 1: shiritat me thyerje >.


Vija e thyer është me gjerësi 7 mm ± dhe me lartësi thyerje 17 mm. Ajo është e punuar me relief, me 3 ndarje (2.5 mm - 2 mm - 2.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe në formë cilindrike. Për montim, shirit ka dy fileto metalike, një në majtë dhe një në të djathtë. Foto për referencë.

	Elementi 2: Shiriti i drejtë i ngushtë në formë trapezi (7 mm ±) Shirit metalik me ngjyrë të artë, i drejtë, gjerësi 7 mm ± dhe trashësi 1.5 mm ±. Gjatësia e këtyre shiritave duhet të jetë sa hapësira brenda kornizës anësore të kuqe. Shiriti është i punuar në relief me 3 shirita pa ndarje, (2.5 mm - 2 mm - 2.5 mm), ajo e mesit është më e ngritur dhe në formë cilindrike. Për montim, shiriti ka dy fileto metalike, një në të majtë dhe një në të djathtë. Foto për referencë.
	Elementi 3: Shiriti i drejtë i ngushtë në formë drejtkëndore (7 mm ±) Shirit me gjerësi 7 mm ± me ngjyrë të artë. Gjatësia e shiritit është 46 mm. Shiriti është i punuar me relief i ndërtuar nga tre "shirita" të drejtë pa ndarje (2.5 mm-2 mm-2.5 mm). Ndarja e mesit është më e ngritur dhe me formë cilindrike. Për montim, shiriti ka dy fileto metalike, një në të majtë dhe një në të djathtë. Foto për referencë:
	Elementi 4: Shiriti i drejtë i gjerë në formë trapezi (13 mm ±) Shirit metalik me ngjyrë të artë, i drejtë, gjerësi 13 mm ± dhe trashësi 1.5 mm ±. Gjatësia e këtyre shiritave duhet të jetë sa hapësira brenda kornizës anësore të kuqe. Shiriti është i punuar në relief me 5 shirita pa ndarje, (2.5 mm - 2 mm - 2.5 mm - 2 mm - 2.5 mm), 2 shiritat e mesit janë më të ngritur dhe në formë cilindrike. Për montim, shirit ka dy fileto metalike, një në të majtë dhe një në të djathtë. Foto për referencë.
	Elementi 5. Ylli i vogël (D = 18 mm ±). Ylli dekorativ metalik, me ngjyrë të artë (d. 18 mm). Trashësia në qendër e yllit është 2.5 mm +/- 0.1 mm, ndërsa në cepa 1.5 mm +/- 0.1 mm. Ngjyra e yllit është e artë. Ylli është i derdhur dhe i punuar me relief në sipërfaqen e tij. Ai ka disa gdhëndje dhe vijëzime. Për montim, ylli ka 1 fileto metalike, në qendër të yllit. Shiko foton për

	referencë.
	Elementi 6. Ylli i mesëm ($D = 20\text{mm} \pm$). Ylli dekorativ metalik, me ngjyrë të artë ($d. 20\text{ mm}$). Trashësia në qendër të yllit është $2.5\text{ mm} \pm 0.1\text{ mm}$, ndërsa në cepa $1.5\text{ mm} \pm 0.1\text{ mm}$. Ngjyra e yllit është e artë. Ylli është derdhur dhe i punuar me relief në sipërfaqen e tij. Ai ka disa gdhëndje dhe vijëzime. Për montim, ylli ka 1 fileto metalike, në qendër të yllit. Shiko foton për referencë.
	Elementi 7: Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut. Përkrenarja ka përmasa gabarit $25\text{ mm} \times 31\text{ mm}$ dhe trashësi $2.5\text{ mm} \pm 0.1\text{ mm}$. Ngjyra e artë e përdorur për përkrenaren e Skënderbeut është e njëjtë me atë të gjithë elementëve të tjerë metalike. Prodhimi i përkrenares dhe montimi duhet të jetë në mënyrë të tillë që të shohin njëra - tjetrën përballë. Për montim, përkrenarja ka dy fileto metalike, në pozicion vertikal. Elementët në gradë janë prodhuar në formatin 3D. Shiko foton për referencë.

7. KOMPOZIMI I GRADAVE SIPAS HIERARKISË

a. Shenja e spaletit - *Student/ Kursant*



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit i artë metalik i drejtë (7 mm x 46 mm ±)
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut e stilizuar


Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës. Mesi i shiritit të drejtë duhet të përkojë me aksin qëndror të gradës.

Distanca e shiritit të drejtë të artë nga konturi i kuq duhet të jetë 4 mm ±.

Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar në qendër të fushës së gradës dhe e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si shiriti i drejtë dhe përkrenarja, fiksohen në gradë me anë të 2 (dy) filetove metalike secila.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



b. Grada e spaletave të rangut - Inspektor



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 (një) kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit i artë metalik, në formë >
- 1 (një) përkrenare metalike e Skenderbeut

Shiriti i artë i thyer me formë >, duhet vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Këmbët e shiritit > janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.


Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 16 mm ± mbi kulmin e shiritit të dytë në formë > dhe mesi i bazës së saj është vendosur përgjatë aksit qendror të gradës. Përkrenarja duhet të jetë e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si vija e thyer dhe përkrenarja, fiksohen në bazament me anë të 2 (dy) filetove metalike secila.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



c. Grada e spaletave të rangut - Inspektor i dytë



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 (një) kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 2 (dy) shirita, të artë metalik, në formë >
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut

Dy shirita të thyera me formë >> duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Distanca e shiritave nga njëri-tjetri duhet të jetë 3mm. Këmbët e shiritit > të pare janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.

Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 5 mm ± mbi kulmin e shiritit të dytë në formë > dhe mesi i bazës së saj është vendosur përgjatë aksit qendror të gradës. Përkrenarja duhet të jetë e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si vijat e thyera dhe përkrenarja, fiksohen në bazament me anë të 2 (dy) filetove metalike secila.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



d. Grada e spaletave të rangut - Inspektor i parë



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:


- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 3 shirita të artë metalikë, në formë >>>
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut

Tre shirita të thyera me formë >>> duhen vendosur brenda kornizës së kuqe plastike me drejtim nga maja e gradës. Distanca e shiritave nga njëri-tjetri duhet të jetë 3 mm. Këmbët e shiritit > të parë janë të puthitura me bazën e gjerë të gradës.


Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 5 mm ± mbi kulmin e shiritit të tretë në formë > dhe mesi i bazës së saj është vendosur përgjatë aksit qendror të gradës. Përkrenarja duhet të jetë e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si vijat e thyera dhe përkrenarja, fiksohen në bazament me anë të 2 (dy) filetove metalike secila.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



e. Grada e spaletave të rangut – Nënkomisar



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit metalik i drejtë i ngushtë (7 mm ±)
- 1 (një) yll metalike me 5 cepa me diametër 18 mm ±
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut e stilizuar


Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës.

Ylli dekorativ metalik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 18 mm, pozicionohet sipas skemës në qendër, në distancë rreth 11 mm ± nga shiriti i drejtë tek qendra e yllit.


Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 12 mm ± mbi kulmin e yllit. Përkrenarja duhet të jetë e pozicionuar e barazlarguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si shiriti i drejtë dhe përkrenarja, fiksohen në gradë me anë të 2 (dy) filetove metalike secila. Ylli fiksohet me 1 fileto metalike.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.




f. Grada e spaletave të rangut - Komisar




- Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës.

Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 12 mm ± mbi kulmin e yllit. Përkrenarja duhet të jetë e pozicionuar e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.





Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2,5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit metalik i drejtë i ngushtë (7mm ±)
- 3 (tre) yje metalike me 5 cepa me diametër 18 mm ±
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut e stilizuar


Shiriti i drejtë duhet puthitur me konturin e kuq plastik në bazën e gjerë të gradës.

3 Yjet dekorativë metalikë, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 18mm, pozicionohen sipas skemës në qendër, me distancë rreth 11 mm ± nga shiriti i drejtë tek qendra e yjeve. Qendrat e yjeve janë të barazlanguara 15 mm nga konturi i kuq. Distanca ndërmjet qendrave të yjeve është 20 mm. Ylli i tretë pozicionohet në qendër të aksit të gradës me distancë të qendrës së yllit nga shiriti plastik i drejtë 27 mm.

Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 12 mm ± mbi kulmin e yllit. Përkrenarja duhet të jetë e pozicionuar e barazlanguar nga të dy anët e kornizës.

Elementët, si shiriti i drejtë dhe përkrenarja, fiksohen në gradë me anë të 2 (dy) filetove metalike secila. Yjet fiksohen me 1 fileto metalike.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



h. Grada e spaletave të rangut - Drejtues



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 90 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit metalik i drejtë i gjerë (13 mm $\pm$)
- 1 (një) yll i mesëm me 5 cepa me diametër 20 mm.
- 1 (një) përkrenare metalike e Skënderbeut e stilizuar


Shiriti i drejtë i gjerë duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjerë të gradës.

Ylli dekorativ metalik, me ngjyrë të artë, me pesë cepa me diametër 20 mm, pozicionohet sipas skemës, në aksin qendror të gradës i barazlarguar nga konturi i kuq. Qendra e yllit ka distancë 14mm nga shiriti i drejtë.

Përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut është pozicionuar 10 mm $\pm$ mbi kulmin e yllit. Përkrenarja duhet të jetë e barazlarguar nga të dy anët e kornizës.


Elementët, si shiriti i drejtë dhe përkrenarja, fiksohen në gradë me anë të 2 (dy) filetove metalike secila. Ylli fiksohet me 1 fileto metalike.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.




i. Grada e spaletave të rangut - Drejtues i parë


Elementi 1: Shiriti mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari



Skema e mbivendosjes se elementeve




Elementi 2: Ylli me diametër 22mm




Qëndisja e yllit është me relief dhe me trashësi: në cepat 1,5 mm dhe në qendër 2,5mm
Ylli është qëndisur në relief, në drejtim paralel me cepat që vijnë me kulm mbylljeje në drejtim të qendrës.

Elementi 3: Përkrenarja e Skënderbeut



j. Grada e spaletave të rangut - *Drejtues i lartë*



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 105 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shiriti mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari (gjerësi 23 mm ±)
- 1 (një) yll i qëndisur, i madh me 5 cepa (d.22 mm)
- 1 përkrenare e qëndisur e Skënderbeut (përmasa gabarit 25 mm x 31 mm dhe trashësi 2.5mm)


Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik me bazën e gjerë të gradës.

Mbi të pozicionet një yll i qëndisur me distancë 15 mm nga shiriti i qëndisur tek qendra e yllit. Ylli është pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të baraslarguara.


Sipër yllit të qëndisur pozicionohet përkrenarja e qëndisur e Skënderbeut me distancë 5 mm nga cepi i yllit.

Ylli dhe përkrenarja janë të pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të barazlanguara.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



k. Grada e spaletave të rangut - Drejtues madhor



Bazamenti i gradës duhet të ketë pamje të sipërme në formë trapezi, me dimensione 60 mm x 105 mm x 52 mm. Në pjesën e sipërme të gradës duhen vendosur elementët dekorativë:

- 1 kornizë e kuqe plastike (2.5 - 3 mm)
- 1 (një) shirit mëndafshi i dekoruar me fije metalike ngjyrë ari (gjerësi 23 mm ±)
- 2 (dy) yje të qëndisur, të mëdhenj, me 5 cepa (d.22 mm)
- 1 përkrenare e qëndisur e Skënderbeut (përmasa gabarit 25 mm x 31 mm dhe trashësi 2.5mm)


Shiriti i mëndafshit i qëndisur me fije ari sipas skemës së mësipërme duhet puthitur me konturin e kuq plastik më bazën e gjerë të gradës.

Mbi të pozicionohen dy yje të qëndisur me distancë 15 mm nga shiriti i qëndisur tek qendra e yllit. Ylli është pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të baraslarguara. Yjet kanë nga një distancë 2mm nga njëri-tjetri dhe 2mm nga korniza e kuqe plastike.

Sipër yjeve të qëndisur pozicionohet përkrenarja e qëndisur e Skënderbeut me distancë 5 mm nga cepi i yjeve.

Përkrenarja është e pozicionuar në aksin qendror të gradës me distanca të barazlarguara.

Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.



8. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element përbërës të gradës si p.sh.: përshtatshmëria e materialeve të përdorura, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj
- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Të gjithë elementët e gradës duhet të jenë simetrikë
- Tekstili dhe elementët e tjerë plastikë të gradës duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet
- Në të gjitha dimensionet do të pranohet një tolerancë prej ± 1 mm.
- Produkti përfundimtar duhet të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, përkuljeve, elementëve atmosferik, etj.
- Gjithashtu nga përkulja e lehtë, disa herë e produktit, nuk duhet të shfaqen thyerje apo vrima të vogla.
- Nuk lejohet sprucimi i elementëve metalike.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006

Kujdes! Gradat duhet të punohen me kujdes të veçantë dhe elementët duhet të rezultojnë pa defekte e parregullsi. Në veçanti nuk duhet të shfaqin (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Kokërzim (punime të ashpra), ç'fijezime ose konturime të parregullta në bazament.
- Diferencë ngjyre dhe tonaliteti ndërmjet tyre në bazament.
- Deformime të produkteve të të njëjtit lloj.
- Ndryshim në dendësi dhe ashpërsi të materialit.
- Mospërputhje mes çifteve të gradave.
- Deformime të konfiguracioneve dhe shkëputje të pjesëve, gropëzime ose plasaritje.
- Relieve të plota e jo të rregullta.
- Mungesë të ngjitjes së fletës plastike të tejdukshme te korniza.
- Pjesë të pasalduara ose jo plotësisht të salduara.
- Shkëputje të pjesëve të kornizës.
- Metalizim i parregullt dhe jo rezistent
- Dhe çdo parregullsi tjetër që cënon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

9. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Gradat duhet të jenë të paketuara çift (një e djathtë dhe një e majtë) të ndara sipas rangjeve. Secili çift duhet të mbështillet me një letër të hollë dhe të vendoset në një qese transparente polietileni bashkë me emërtimin e gradës psh: *Grada për rangun Drejtues i Lartë*.

Qeset me gradat vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me adeziv (ngjitës) dhe mbi kuti të jenë të shënuara udhëzimet e mëposhtme (të stampuara ose të vendosura në etiketat me letër ngjitëse):

- udhëzimet e produktit;

- numri i gradave;
- viti i prodhimit;
- emri i kompanisë furnizuese me vulën përkatëse;

Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të mbyllen me ngjitës që sigurohet mbyllja e mirë. Kartoni (me peshë rreth 600 gr/m²) i kutive duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve.

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve ISO*
Për tekstilin e bazamentit të gradës	
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
pH	EN ISO 3071:2006
Azo ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
Për elementët metalikë	
Përbërja	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	
Për produktin e gatshëm	

Rezistenca ndaj përkuljes dhe fërkimit.	Në palosjen e bazamentit të gradës nuk duhet të shfaqen prishje, plasaritje, humbje ngjyrash, gropëzime dhe deformime të vazhdueshme.
Rezistenca ndaj korrozionit.	Rezistencë ndaj ndryshkjes dhe degradimit, si gjatë përdorimit të tyre dhe ndaj agjenteve të jashtëm. Nuk duhet të shfaqë asnjë ndryshim vizual ose korrozion.
Rezistenca ndaj ujit	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë $25^{\circ}\text{C} \pm 2$.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion <i>sapun marseje</i> 3% në 25°C .
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool etilik e më pas me benzinë.
Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në solucionin e klorurit të sodiumit në 1% në 25°C
Kontrolli i prezencës së fletës mbrojtëse të tejdukshme plastike tek korniza.	Kampioni do të zhytet për pak sekonda në klorur metileni puro dhe pastaj do të shpëlahet me ujë. Nëse ekziston fleta plastike mbrojtëse e tejdukshme ajo do të shqitet lehtësisht. Tejdukshmëria e shtresës mbrojtëse dallohet dhe nën veprimet e forta mekanike.

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

“ Stema e Policisë dhe Shenjat dalluese të krahut ”

HYRJE

“Stema e Policisë dhe Shenjat dalluese të krahut për punonjësit e Policisë së Shtetit ” për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të vendosen te mëngët. Në mëngën e majtë do të vendoset Stema e Policisë së shtetit, ndësa në mëngën e djathtë do të vendosen shenjat e krahëve ose logo sipas shërbimeve të policisë.

Shenjat e krahut dhe elementët e tjerë identifikues në pjesën e pasme kanë të fiksuar “velcro mashkull”. Ato janë lehtësisht të montueshme dhe të çmontueshme në uniformat përkatëse, pasi në to është aplikuar një velcro femër me po të njëjtat përmasa.

Stema dhe shenjat duhet të prodhohen me materialet dhe format e kërkuara nga Policia e Shtetit. Ato duhet të prodhohen në bazë të pamjes së jashtme, modelit, përmasave dhe ngjyrave të përcaktuara në këtë dokument.

		
Stema e Policisë së Shtetit	Logo e Policisë së Shtetit	Shenjë krah Policia e Rendit
		
Shenjë krah Shqiponjat	Shenjë krah Policia Rrugore	Shenjë krah Policia Kufitare



TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKUJVE

“Stema e Policisë dhe shenjat dalluese të krahut për punonjësit e Policisë së Shtetit”

1. MATERIALET

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Stema dhe Shenjat dalluese të krahut ” ndahen në:

- a. Materiali i bazamentit
 - b. Elementët ndihmës
- a. Materiali i bazamentit duhet të jetë material plastik kloruri polivinili (PVC) i cilësisë së lartë, që të rezistojë në kohë, të ketë fleksibilitet dhe plasticitet. Materiali i përdorur duhet të jetë rezistent ndaj efektit të agentëve atmosferikë në mënyrë që të mos i ndryshojë ngjyra me kalimin e kohës. Materiali i bazamentit duhet të ketë këto të dhëna:

Ngjyra	Sipas skemave të dhëna
Përbërja %	100 % polivinil kloruri PVC
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5 (Shkalla Gri)
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)

Ngjyrat e produktit përfundimtar duhet të jenë të njëjta me ngjyrën e kampionit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t’i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larges me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës duhet të jetë: *e qëndrueshme* - nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* - nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* – nota 6: *shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: stemat dhe shenjat do të fërkohen për një kohë të caktuar me një cohë të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyrat nuk transferohen tek tekstili i bardhë.

- b. Elementët dhe materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit "Stemat dhe shenjat dalluese të krahut për punonjësit e Policisë së Shtetit" janë :

Shirit Velcro Mashkull		
Shirit velcro mashkull për vendosjen e gradës, numrit të identifikimit ose shënjes së mbiemrit në veshje.	Përmasat	80 mm x 70 mm
	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia	1.6 mm
	Masa lineare	40 g/m $\pm 3\%$
	Ngjyra	Blu e errët
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme	
	E ftohtë	- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit 180° C
		pika e shkrirjes 210 – 250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës	
	Në larje	jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë	
	Në djersë	
	Në fërkim	

Të gjithë këto elementë dhe aksesorë, mund të zëvendësohen me material të ngjashëm, vetëm nëse kanë karakteristika të barabarta dhe/ose të përmirësuara, që t'i përgjigjen plotësisht specifikave të kërkuara për prodhimin e produktit.

KUJDES! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

- c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *stema dhe shenjat*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietileni që mbyllet me ngjitje për paketimin e 3 copë shenjash	1 letër e hollë për paketimin e 3 copë shenjave
1 kuti kartoni për paketimin e 60 copë shenjash	

2. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyrat referencë që prodhuesi duhet t'i ketë parasysh duhet të jenë ato ngjyra që janë paraqitur në dizenjot e këtij specifikimi teknik. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

3. PËRMASAT

Bazamenti i stemës dhe shenjave ka pamje të sipërme në formë mburoje (shqyt), por format e tyre ndryshojnë sipas shërbimit të punonjësve të policisë.

Stema, shenjat e krahut dhe logo duhet të ketë këto përmasa:

- 80 mm gjatësi x 70 mm gjerësi

Kujdes!!! Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementëve të gradave është ± 1 mm.

4. SASIA E PRODHIMIT

Artikulli "Stemat dhe shenjat dalluese të krahut të punonjësve të Policisë së Shtetit" duhet të prodhohen, sipas sasisë së specifikuar nga Policia Shtetit. Prodhuesi ka për detyrë që të parashikojë prodhimin e kësaj sasive saktësisht sipas specifikimeve të porositësit.

5. NDËRTIMI TEKNIK I BAZAMENTIT

Stema dhe Shenjat duhet të realizohen me material plastik me bazë PVC. Ato duhet të jenë të dekoruara në sipërfaqe me relief të vijëzuar dhe elementët identifikues të jenë të punuar me gdhendje.

Ato duhet të prodhohen në bazë të kërkesave të Policisë së Shtetit, duke respektuar në mënyrë rigoroze pamjen e jashtme të tyre, formën, modelin, përmasat dhe ngjyrat e shënuara në këtë specifikim teknik.

Materialet e përdorura për prodhimin e tyre duhet të kenë jetëgjatësi dhe të mos pësojnë ndryshime në ngjyrë apo në formë nga ndikimi i faktorëve të jashtëm. Ato duhet të rezistojnë kohës dhe të kenë fleksibilitet në përdorim.

Stemat duhet të jenë të punuara bukur dhe të mos kenë asnjë defekt teknik dhe sipërfaqësor. Elementët e shenjës duhet të kenë pamje të rregullt pa deformime dhe gabime.

Stema dhe Shenjat e krahut vendosen në uniformë me anë të mekanizmit Velcro. Ato duhet të jenë të veshura nga sipër me një shtresë të hollë plastike të tejdukshme mbrojtëse. Kjo shtresë duhet të jetë e pashqitshme. Ajo ruan efektin e punimeve të imëta, shkëlqimin e ngjyrave, sipërfaqen nga oksidimi që mund të shkaktojë agjentët atmosferik, etj.

1. KOMPOZIMI I STEMËS DHE I SHENJAVE DALLUESE

a. Stema e Policisë së Shtetit, për shenjat e krahut



- Përmasat e stemës janë 70 x 80 mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 5 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i stemës përbëhet nga mburoja (shqyti), shqiponja dykrenare, përkrenarja e Skënderbeut, një shqyt i vogël me shqiponjë dhe shkrimi POLICIA E SHETIT. Përmasat e stemës janë 70 x 80 mm. Materiali i stemës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të stemës janë e artë, e kuqe, blu e errët dhe e zezë.

Sipërfaqja e mburojës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar ndërsa perimetri i saj përshkohet nga një shirit plastik me gjerësi $1.5 \text{ mm} \pm$, me punim dekorativ dhe me ngjyrë të artë të shndritshme.

Mburoja është e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe.

Në qendër të shqytit është vendosur shqiponja dykrenare me ngjyrë të artë të shndritshme. Modeli i shqiponjës duhet të ketë pamjen zyrtare të stemës së Policisë së Shtetit që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti, në dokumente të tjerë zyrtarë ose në faqen zyrtare të internetit të Policisë së Shtetit. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Mbi shqiponjë është vendosur përkrenarja e Skënderbeut, me profil majtas, të dyja me relief dhe të stilizuara sipas figurës.

Përmasat e shqiponjës së bashku me përkrenaren janë 57 mm x 39 mm.

Bishti i shqiponjës është pozicionuar $7 \text{ mm} \pm$ mbi kornizën e artë dhe mesi i saj është pozicionuar në qendër të stemës i cili e ndan shqiponjën në dy pjesë simetrike.

Në gjoks të shqiponjës është aplikuar një mburojë (shqyt) e vogël e kuqe, me përmasa 11 mm gjatësi x 10 mm gjerësi, ku në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë e flamurit kombëtar, me përmasë 7mm x 7mm.

Sipërfaqja e Shqiponjës dhe e përkrenares duhet të jenë me relief dhe të stilizuara siç janë paraqitur në këtë ilustrim.

Shkrimi është pozicionuar 2 mm poshtë formës së modeluar të mburojës, dhe vjen i harkuar sipas formës së shqytit. Shkrimi duhet të ketë relief të vijëzuar.

Shqiponja, përkrenarja dhe shkrimi duhet të jenë me material të artë të shndritshëm.

Stema të fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të stemës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasë si stema.

b. Logo e Policisë së Shtetit për shenjat e krahut



- Përmasat e logos janë 70 x 80 mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 7 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i stemës përbëhet nga mburoja (shqyti), shqiponja dykrenare, përkrenarja e Skënderbeut me profil djathtas dhe shkrimi POLICIA. Përmasat e stemës janë 70 x 80 mm. Materiali i stemës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të stemës janë e artë, e kuqe, blu e errët.

Pjesa e sipërme ka ngjyrë të kuqe të ndezur me gjerësi 13mm $\pm$.

Shkrimi është pozicionuar i barazlarguar nga skajet e konturit të kuq.

Sipërfaqja e mburojës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar ndërsa perimetri i saj përshkohet nga një shirit plastik me gjerësi 2.5- 3 mm $\pm$, me punim dekorativ dhe me ngjyrë të kuqe të ndezur.

Në qendër të shqytit është vendosur shqiponja dykrenare me ngjyrë të artë të shndritshme. Modeli i shqiponjës duhet të ketë pamjen zyrtare të flamurit kombëtar të Republikës së Shqipërisë që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti dhe në dokumente të tjerë zyrtarë. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Përmasat e shqiponjës janë 40 mm x 36 mm. Bishti i Shqiponjës është pozicionuar 8 mm ± mbi kornizën e kuqe dhe mesi i saj është pozicionuar përgjatë aksit qendror të logos i cili e ndan shqiponjën në dy pjesë simetrike.

Mbi shqiponjën dy krenare është vendosur përkrenarja e Skënderbeut me profil djathtas, të dyja të punuara me relief dhe të stilizuara sipas figurës. Ajo pozicionohet në mes të dy krerëve të shqiponjës, në distancë 2 mm. Përmasat e përkrenares janë 13 mm x 12 mm.

Shqiponja, përkrenarja dhe shkrimi duhet të jenë me material të artë të shndritshëm. Sipërfaqja e Shqiponjës dhe e përkrenares duhet të jenë me relief dhe të stilizuara siç janë paraqitur në këtë ilustrim. Shkrimi duhet të ketë relief të vijëzuar.

Stema të fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të stemës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasë si stema.

c. Shenjë krahu – POLICIA E RENDIT



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80 mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 5 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga mburoja e madhe dhe mburoja e vogël, përkrenarja e Skënderbeut, dy kallinj gruri, një shpatë dhe shkrimi POLICIA E RENDIT.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë e artë, e kuqe, blu, e zezë dhe ngjyrë argjendi.

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të artë të shndritshme, me gjerësi 1.5 mm $\pm$, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Shkrimi është pozicionuar 3 mm poshtë formës së modeluar të mburojës dhe vjen i harkuar sipas formës së shqytit. Shkrimi në të dy anët është i barazlanguar nga korniza anësore e artë.

Brenda mburojës (shqytit) së madhe është një mburojë (shqyt) më e vogël blu me përmasa 53 mm x 45 mm, me kornizë të artë me gjerësi 1mm.

Brenda tij në qendër është vendosur një shpatë e argjendtë e vendosur vertikalisht me gjatësi 48mm dhe gjerësi të tehut të saj 3mm. Doreza e shpatës është pozicionuar 1mm mbi kornizën e poshtme të artë të shqytit të vogël dhe përgjatë aksit qendror duke e ndarë shpatën në dy pjesë simetrike.

Përkrenarja është pozicionuar 17mm mbi kornizën e poshtme të artë të shqytit të vogël dhe mesi i saj është përgjatë aksit qendror. Përkrenarja e Skenderbeut ka përmasa gabarit 20 mm x 27 mm.

Modeli i shenjës së Policisë së Rendit duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe me detaje të stilizuara.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

d. Shenjë krahut – SHQIPONJAT



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80 mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit $\pm$ 5 mm

- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga një mburojë (shqyti), 2 trekëndësja blu, koka e shqiponjës, dhe shkrimi SHQIPONJAT.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë e artë, e kuqe, blu e errët, e zezë dhe e bardhë.

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të artë të shndritshme, me gjerësi 1.5 mm ±, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Baza e të dy trekëndësive është pozicionuar në pjesën anësore të majtë të kornizës së artë. Brinja e parë e drejtë e trekëndëshit është vendosur horizontalisht e pozicionuar 17 mm ± mbi kornizën e poshtme të artë të shqytit.

Brinja e dytë e drejtë e trekëndëshit të dytë e vendosur horizontalisht është pozicionuar 28 mm mbi kornizën e poshtme të artë të shqytit.

Përmasat në ekstreme të kokës së shqiponjës janë 41 mm e gjatë dhe 44mm e gjerë.

Shkrimi është pozicionuar 2 mm ± poshtë formës së modeluar të mburojës,

Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe me detaje të stilizuara.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velkro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

e. Shenjë krahut- POLICIA RRUGORE



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80 mm

- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit $\pm 7\text{mm}$
- Ngjyra e shkrimit: e verdhë fluoreshente
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga mburoja e madhe dhe mburoja e vogël, motivi shahu, një rrotë, një pishtar, dhe shkrimi POLICIA RRUGORE.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë: e kuqe, e zezë, e verdhë fluoreshente (green lime fluorescente), blu, gri dhe e bardhë.

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të kuqe, me gjerësi $1.5\text{ mm} \pm$, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Në pjesën e sipërme të shqytit me një gjerësi $11\text{ mm} \pm$ është aplikuar një motiv shahu bardhë e zi. Rreshtat përbëhen nga 5 (pesë) kuti shahu të bardha dhe 5 (pesë) të zeza. Gjerësia e rreshtit të parë dhe të dytë është $5\text{ mm} \pm$.

Shkrimi është pozicionuar 2 mm mbi kornizën e kuqe.

Në qendër, është aplikuar një mburojë (shqyt) më e vogël ngjyrë e verdhë fluoreshente me përmasa $53\text{ mm} \times 45\text{ mm}$.

Në aksin qendror të stemës është aplikuar një pishtar blu me gjatësi 40 mm dhe gjerësi 4 mm në pjesën e sipërme, dhe 3 mm në pjesën e poshtme. Pishtari është me flakë të kuqe e cila "fryn" në anën e djathtë.

Gjithashtu është aplikuar një rrotë me ngjyrë gri e konturuar me një rreth me gjerësi 1.5 mm me ngjyrë të zezë dhe diameter 22 mm . Qendra e rrotës pozicionohet 34 mm mbi kornizën e kuqe të poshtme.

Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe elementët të jenë të stilizuar.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

f. Shenjë krah- POLICIA KUFITARE DHE E MIGRACIONIT



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80 mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 7 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga mburoja e madhe dhe mburoja e vogël, harta e Shtetit Shqiptar, dy kalli gruri, përkrenarja e stilizuar e Skënderbeut, tre vijat e zeza, dhe shkrimi POLICIA KUFITARE.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë: e artë, e kuqe, e zezë, e gjelbërt dhe gri.

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të artë, me gjerësi 1.5 mm $\pm$, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Në qendër ka një mburojë (shqyt) më të vogël me ngjyrë të blertë, me hartën e Shqipërisë ngjyrë gri, të vendosur përgjatë aksit qendror të shenjës. Përmasat e shqytit të vogël janë 50mm x 43mm.

Fusha e blertë është ndarë në gjashtë pjesë, nëpërmjet një vije të zezë dhe dy vija të tjera diagonale që kryqëzohen.

Harta e Shqipërisë është pozicionuar e barazlanguar nga të dy skajet e shqytit të vogël.

Në cepin e poshtëm, në qendër është vendosur përkrenarja e Skënderbeut e stilizuar e artë me përmasa gabarit 8 mm x 10 mm.

Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti, në dokumente të tjerë zyrtarë ose në faqen zyrtare të internetit të Policisë së Shtetit. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe elementët të jenë të stilizuar.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

g. *Shenjë krah- E FORCAVE SPECIALE – RENE A*



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 7 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga mburoja e madhe me cepin e majtë të harkuar nga brenda, një krah i majtë ngjyrë gri, një rrufe ngjyrë e artë, një shirit blu i errët dhe shkrimi RENE A.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të artë, me gjerësi 1.5 mm $\pm$, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Në fushë është një krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri me hijëzime të zeza, që shtrëngon një rrufe të artë. Poshtë në distancë 22 mm nga konturi i artë është një shirit horizontal blu me gjerësi 10mm.

Shkrimi është pozicionuar në qendër të shiritit horizontal blu.

Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe elementët e saj të jenë të stilizuar.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë: e artë, e kuqe, blue e errët, e zezë dhe gri.

h. Shenjë krah- E NDËRHYPJES SË SHPEJTË – FNSH



- Përmasat e shenjës janë 70 x 80mm
- Lloji i shkrimit: Myriad Pro Bold
- Madhësia e shkrimit ± 7 mm
- Ngjyra e shkrimit e artë
- Lloji i punimit në sipërfaqe: 3D dhe me relief të vijëzuar

Kompozimi i shenjës përbëhet nga mburoja e madhe me cepin e majtë të harkuar nga brenda, një krah i majtë ngjyrë gri, një shigjetë ngjyrë e artë, një shirit blu i errët dhe shkrimi FNSH.

Materiali i shenjës duhet të jetë PVC (plastik).

Ngjyrat zyrtare të shenjës janë: e artë, e kuqe, blue e errët, e zezë, dhe gri.

Sipërfaqja e shenjës duhet të jetë e trajtuar me relief dekorativ të vijëzuar dhe perimetri i shenjës është i konturuar me një shirit me ngjyrë të artë, me gjerësi 1.5 mm $\pm$, i punuar në sipërfaqe me vijëzime të pjerrëta, të drejta.

Gjatësia e shigjetës është 45mm. Poshtë në distancë 22 mm nga konturi i artë është një shirit horizontal blu me gjerësi 10mm.

Shkrimi është pozicionuar në qendër të shiritit horizontal blu

Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç që është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyra, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Sipërfaqja e shenjës duhet të punohet me relief të vijëzuar dhe elementët e saj të jenë të stilizuar.

Shenja e krahut fiksohet në uniformë me anë të mekanizmit velcro. Velcro mashkull, është vendosur në pjesën e pasme të shenjës. Velcro është e prerë në po të njëjtën formë dhe përmasa si shenja.

8. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element përbërës të gradës si p.sh.: përshtatshmëria e materialeve të përdorura, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj
- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Të gjithë elementët e stemave dhe shenjave duhet të jenë simetrikë
- Stema dhe shenjat duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet
- Në të gjitha dimensionet do të pranohet një tolerancë prej ± 1 mm.
- Produkti përfundimtar duhet të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, përkuljeve, elementëve atmosferik, etj.
- Gjithashtu nga përkulja e lehtë, disa herë e produktit, nuk duhet të shfaqen thyerje apo vrima të vogla.
- Nuk duhet të vihen re ç'fijëzime përgjatë anëve të lira të velcros "mashkull" edhe pas disa operacionesh të përsëritura të montimit dhe ç'montimit.
- Materialet e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.

Kujdes! Stemat dhe shenjat duhet të punohen me kujdes të veçantë dhe elementët duhet të rezultojnë pa defekte e parregullsi. Në veçanti nuk duhet të shfaqin (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Kokërzim (punime të ashpra), ç'fijëzime ose konturime të parregullta në bazament.
- Diferencë ngjyre dhe tonaliteti ndërmjet tyre në bazament.
- Deformime të produkteve të të njëjtit lloj.
- Ndryshim në dendësi dhe ashpërsi të materialit.
- Pavazhdueshmëri.
- Deformime të konfiguracioneve dhe shkëputje të pjesëve, gropëzime ose plasaritje.
- Relieve të plota e jo të rregullta.
- Mungesë të ngjitjes së fletës plastike të tejdukshme.
- Pjesë të pasalduara ose jo plotësisht të salduara.
- Dhe çdo parregullsi tjetër që cënon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

9. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Stema e Policisë së Shtetit dhe Shenjat e krahut duhet të vendosen të ndara sipas shërbimeve. Secili element duhet të mbështillet me një letër të hollë dhe të vendoset në një qese transparente polietileni bashkë me emërtimin. Brenda qeseve duhet të futen nga 3 stema, 3 shenja krahut ose 3 logo.

Qeset vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me anën e një shiriti adeziv (ngjitës) dhe gjithashtu duhet të jenë shënuar udhëzimet e mëposhtme (të stampuara ose të vendosura në etiketat me letër ngjitëse) :

- udhëzimet e produktit;
- numri i gradave;
- viti i prodhimit;
- emri i kompanisë furnizuese me vulën përkatëse;

Kutitë duhet të jenë të rregullta dhe të mbyllen me ngjitës duke siguruar mbyllje të mirë. Kartoni (me peshë rreth 600 gr/ m²) i kutive duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurtë të produkteve.

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli



Analizat	Metodat e testimeve
Për elementët plastikë	
Përbërja	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	
Për produktin e gatshëm	
Rezistenca ndaj përkuljes dhe fërkimit.	Në palosjen e bazamentit të gradës nuk duhet të shfaqen prishje, plasaritje, humbje ngjyrash, gropëzime dhe deformime të vazhdueshme.
Rezistenca ndaj ujit	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25° C + 2.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion <i>sapun marseje</i> 3% në 25°C.
Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool etilik e më pas me benzinë.
Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.	Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në solucionin e klorurit të sodiumit në 1% në 25°C
Kontrolli i prezencës së fletës mbrojtëse të tejdukshme plastike tek elementët plastikë.	Kampioni do të zhytet për pak sekonda në klorur metileni puro dhe pastaj do të shpëlahet me ujë. Nëse ekziston fleta plastike mbrojtëse e tejdukshme ajo do të shqitet lehtësisht. Tejdukshmëria e shtresës mbrojtëse dallohet dhe nën veprimet e forta mekanike.

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kordona dekorativë për uniformën ceremoniale

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kordonë dekorativë për uniformën ceremoniale* duhet të jetë i cilësisë së lartë me këto të dhëna teknike:

Kordonët metalik					
Ngjyra	e artë				
Përbërja	veshja e jashtme	100% metalike			
	në brendësi	100% pambuk			
Thurja	bullion metalik methurje tubolare me shkëlqim mesatar				
Qëndrueshmëria e ngjyrës	shiritat duhet të kenë qëndrueshmëri maksimale				
Qëndrueshmëria ndaj fërkimit					
Kordonët me ngjyra					
	bojëqielli	e gjelbër	e verdhë	e artë	e argjendtë
Ngjyra					
Përbërja	100% poliestër				
Thurja	gërshet methurje tubolare me shkëlqim mesatar				
Qëndrueshmëria e ngjyrës	shiritat duhet të kenë qëndrueshmëri maksimale				
Qëndrueshmëria ndaj fërkimit					
ph	4-9				
Azo ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishëm				

Ngjyra e materialeve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës duhet të jetë: *e qëndrueshme* dhe *shumë e qëndrueshme*.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e materialeve, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kordonë që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- sipërfaqe jo të njëtrajtshme,
- tjetërsime të pamjes,

- punime të ashpra,
- tonalitete të ngjyrës,
- luhatje në dendësinë e kordonëve,
- deformime nëthurje,
- shkëputje të pjesëve të kordonëve ose pjesë jo të punuara mirë,
- kordonë methurje jo të njëtrajtshme ose methurje të gabuar,
- njolla vaji ose boje,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të artikullit.

b. Lista e materialeve ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kordonë dekorativë për uniformën ceremoniale*:

Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet e nevojshme.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	30 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si kordoni tek i cili do të qepet

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *kordonë dekorativë për uniformën ceremoniale* janë:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.


1 qese polietileni për kordonin e kapelës, 1 për kordonin e supit dhe 1 për paketimin e dy kordonave bashkë
1 etiketë adezive për kordonat
1 kuti kartoni për paketimin e kordonave
1 etiketë adezive për informacionin që duhet të shkruhet tek kutitë

Të gjithë elementet mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare

2. PËRMASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikujt *kordonë dekorativë për uniformën ceremoniale* do të porositen dhe do të prodhohen në sasi të përcaktuara tek lista e rangjeve të Policisë së Shtetit.

3. NGJYRAT REFERENCE



Ngjyrë argjendi për kordonat ceremonialë të gradave *Inspektor–Kryekomisar* në *Akademinë e Sigurisë, Policinë Kriminale, Drejtorinë e Përgjithshme të Hetimit të Krimit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse* sipas spektrit **CIELCH 69, 1.245, 225.898**

Ngjyrë e artë për kordonat ceremonialë të gradave *Drejtues–Drejtues Madhor* në *Policinë e Shtetit dhe gradave Inspektor–Kryekomisar* në *Repartet dhe Trupat Ceremoniale të Drejtorive Vendore*, sipas spektrit **CIELCH 72, 63.619, 74.057**.



Ngjyrë bojëqielli për kordonët ceremonialë të *Strukturave të Sigurisë Publike* në *Policinë e Shtetit* sipas spektrit **CIELCH 83. 14.881, 241.482**

Ngjyrë e verdhë për kordonat ceremonialë të *Policisë Rrugore* sipas spektrit **CIELCH 85, 46.185, 102.600**

Ngjyrë e gjelbërt për kordonat ceremonialë të *Policisë Kufitare dhe Migracionit* sipas spektrit **CIELCH 68, 8.155, 128.723**.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.




Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. NDËRTIMI TEKNIK I KORDONËVE

Kordonët dekorativë të gradave *Drejtues–Drejtues Madhor në Policinë e Shtetit*:

Karakteristika të përbashkëta			
Struktura		bullion, me fije metalike	
			
Ngjyra		e artë	
			
Karakteristika të veçanta			
Kordoni dekorativ i kapelës		Kordoni dekorativ i supit	
Gjatësia	31 cm	Gjatësia (standarde)	80 cm
Gjerësia	20 mm	Gjerësia	25 mm
Konstrukti	gërshet	Konstrukti	gërshet
			
Aksesorë	dy ylykë për t'u fiksuar tek kopsat e kapelës	Aksesorë	një ylyk për t'u fiksuar tek kopsa e spaletës
			

Kordonët dekorativë të *Strukturave të Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit, Policisë Rrugore, Policisë Kufitare dhe të Migracionit, Reparteve dhe Trupave Ceremoniale, Akademisë së Sigurisë, Policisë Kriminale, Drejtorisë së Përgjithshme të Hetimit të Krimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.*

Karakteristika të veçanta		
Ngjyra e kordonit të <i>Strukturave të Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit</i>	Ngjyra e kordonit të <i>Policisë Rrugore</i>	Ngjyra e kordonit të <i>Policisë Kufitare dhe Migracionit</i>
Bojëqielli	E verdhë	E gjelbër
		
Ngjyra e kordonit të <i>Repartit dhe Trupës Ceremoniale</i>	Ngjyra e kordonit të <i>Akademisë së Sigurisë, Policisë Kriminale, Drejtorisë së Përgjithshme të Hetimit të Krimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse</i>	
E artë	E argjendtë	
		

Kordonët dekorativë të gradave Inspektor–Kryekomisar në *Strukturat e Sigurisë Publike* në *Policinë e Shtetit*, *Policinë Rrugore*, *Policinë Kufitare dhe të Migracionit*, *Repartet dhe Trupat Ceremoniale*, *Akademinë e Sigurisë*, *Policinë Kriminale*, *Drejtorinë e Përgjithshme të Hetimit të Krimit* dhe në *Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*.

Karakteristika të përbashkëta			
Struktura		gërshet tubolar 	
Kordoni dekorativ i kapelës		Kordoni dekorativ i supit	
Gjatësia	31 cm	Gjatësia (standard)	80 cm
Trashësia	16 mm	Gjerësia	25 mm
Konstrukt	dy kordonë të përdredhur	Konstrukt	gërshet
			
Aksesorë	dy ylykë për t'u fiksuar tek kopsat e kapelës	Aksesorë	një ylyk për t'u fiksuar tek kopsa e spaletës
			

Kujdes! Kordonët dekorativë duhet të prodhohen sipas ngjyrave përkatëse të strukturës së Policisë së Shtetit.

Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull



5. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Kordonët dekorativë duhet të jenë rezistent ndaj agentëve atmosferik.
- Kordonët duhet të kenë pamje të rregullt.
- Ylykët e kordonëve të kapelave duhet të jenë fiksuar mirë me nyjet.
- Ylykët e kordonëve të kapelave duhet kenë pamjen e ylykut të paraqitur si shembull tek tabela e ylykëve.
- Kordonët e kapelave duhet të jenë të përdredhur dhe të ngjeshur mirë që mos të lirohen gjatë përdorimit.
- Shiritat e kordonëve duhet të kenë rezistencë maksimale në ngjyrë. Ato nuk duhet të shfaqin oksidime ose zbehje të ngjyrës gjatë përdorimit.
- Kordonët dekorativë duhet të ketë rezistencë maksimale gjatë përdorimit.
- Kordonët duhet të jenë në përputhje me funksionin e përdorimit.
- Artikujt duhet të prodhohen sipas ngjyrave, përmasave dhe llojit tëthurjeve të specifikuara në këtë dokument.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e shiritave është $\pm 2\%$.
- Materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006
- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

6. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Kordonët duhen futur një herë në qese secili individualisht dhe pastaj në çift, në një qese tjetër: një kordon për kapelën dhe një kordon për supin.

Kordonët duhet të jenë të ndarë sipas gradave dhe strukturave, p.sh.

Komisar	Reparti Ceremonial	1 kordon për kapelën 1 kordon për supin	Ngjyrë e artë
Komisar	Strukturat e Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit	1 kordon për kapelën 1 kordon për supin	Ngjyrë bojëqielli
Komisar	Policia Rrugore	1 kordon për kapelën 1 kordon për supin	Ngjyrë e verdhë
...kështu me radhë për të gjitha çiftet.			

Çdo qese me çifte duhet të ketë një etiketë adezive, në të cilën duhet të shënohet ky informacion:

- struktura
- ngjyra e kordonëve
- grada
- instruksionet e mirëmbajtjes

Kordonët e paketuar duhet të vendosen në kuti. Në çdo kuti duhet të vendosen kordona të së njëjtit lloj. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë kordonësh.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjites (natriban).

Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adezive, në të cilën duhet shënuar:

- lloji i kordoneve dhe ngjyra
- viti i prodhimit
- sasia
- emri i fabrikës prodhuese

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.

	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni.
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2:2016 Tekstilet-Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale. Pjesa 2
pH	EN ISO 3071:2006
Azo ngjyrues	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

KOLAUDIMI

Policia e Shtetit ka të drejtën që të garantojë cilësinë e produktit final nëpërmjet një mekanizmi kontrolli që quhet *kolaudim*. Kolaudimi përfshin këto masa:

1. Verifikimi i fletë-analizës
2. Matjet dhe provat fizike të gradës, shenjave dhe stemave ose elementëve individualë të tyre.
3. Krahimin e rezultateve të matjeve me specifikat e përcaktuara në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*.

Vetëm pasi të jenë bërë të gjitha verifikimet përkatëse nga grupi i kontrollit të cilësisë dhe rezultatet të kenë dalë pozitive, siç është parashikuar në kontratë dhe në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*, *Policia e Shtetit* do të bëjë pranimin e produktit përfundimtar. Artikujt konsiderohen të pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kërkesat e *Specifikimeve Teknike*.

GARANCIA

Afati i garancisë duhet të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve teknike në këtë dokument. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e kolaudimit.

AUTORËSIA

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë pronë e *Policisë së Shtetit* dhe mund të përdoren vetëm nga strukturat e këtij institucioni. Kopjimi dhe shumëfishimi i *Specifikimeve Teknike* të këtyre artikujve është i ndaluar.

Dokumenti i specifikimeve teknike të kapitullit Grada, Shenja dhe Kordonë ka gjithësej 90 faqe.